

V E N D I M
Nr.363, datë 20.5.1996

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.327, DATË
18.7.1994 “PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARIVE
EKONOMIKE”**

Në zbatim të ligjit nr.7687, datë 16.3.1993 “Për statistikën”, me propozimin e Institutit të Statistikës dhe Komisionit të Nomenklaturave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.327, datë 18.7.1994 bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I shtohen pikat e mëposhtme:

"4. Instituti i Statistikës përcakton Kodin e Veprimtarisë Kryesore të Ushtruar (VKU) për të gjitha shoqëritë tregtare, duke u mbështetur në nomenklaturën e veprimtarive ekonomike.

Kjo nuk krijon as të drejta dhe as detyrime kundrejt shoqërive tregtare.

5. Për kodifikimin e plotë të veprimtarisë kryesore të ushtruar, aplikohen kodet suplementare dhe bëhet zbërthimi i klasave duke shtuar një gërmë pas shifrës së katërt të Kodit të Veprimtarisë Kryesore të Ushtruar.

6. Instituti i Statistikës bën azhornimin e veprimtarisë kryesore të ushtruar nga shoqëritë tregtare të kodifikuara sipas pikës 4, duke u mbështetur në rezultatet e anketave statistikore dhe të burimeve të tjera administrative.

7. Instituti i Statistikës vë në dispozicion të përdoruesve shtetërorë dhe privatë të dhëna identifikuese individuale (kodi i identifikimit, emri, mbiemri, adresa e qendrës së veprimtarisë, veprimtaria kryesore e ushtruar, forma juridike, intervali përkatës i numrit të punonjësve) të shoqërive tregtare, të azhoruara sipas burimeve të përmendura në pikën 6.

Për sigurimin e këtyre të dhënave, Instituti i Statistikës bashkëpunon me Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve) mbi bazën e një memorandum bashkëpunimi."

2. Në kreun III shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Komisioni i Nomenklaturave ka në kompetencë të vendosë për reflektimin e modifikimeve të mundshme të Nomenklaturave Statistikore Evropiane në Nomenklaturat Statistikore Shqiptare.”

3. Në kreun IV shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Shpërblimi vjetor që marrin anëtarët e komisionit të bëhet sipas dispozitave në fuqi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi